

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
ZYRA NOTERIALE ELBASAN

Nr. 1809 Rep.
Nr. 808 Kol.



Elbasan , më: 15.05.2018

P R O K U R Ë E P O S A Ç M E

Sot, me datën 15.05.2018 (pesëmbëdhjetë maj dymijë e tetëmbëdhjetë), ditën e marte, para meje Noterit **Evis J.KOBURJA** , anëtare e Dhomës së Noterëve Durres , u paraqit personalisht shtetasi i mëposhtëm:

Z. MIODRAG JANKOVIC, shtetas i Republikës së Serbisë, njohës i gjuhës angleze, i biri i Dragoljub, i datëlindjes 05.12.1978, lindur në Sremska Mitrovica/Serbi dhe banues në Bulevar Patrijarha, Pavla 113, Novi Sad, i identifikuar me pasaportë të Republikës së Serbisë Nr. 012451969, leshuar me date 30.03.2016, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Administratorit dhe Përfaqësuesit Ligjor të Shoqërisë Tregtare "**ALBAMETAL**" **SHA** , me seli në adresën: Durres Lagjja Nr.4, rruga Skenderbej, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë, me Nr. NIPT-i L43402201R, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i asistuar nga përkthyesi i gjuhës angleze, **Znj. ALMA ÇAUSHI** , me numer letërnjoftimi 030993489 edhe me numer personal I05909186I , e njohur personalisht prej meje noterit.

Ai, me vullnetin e tij të lirë dhe të pa vesuar më kërkoi redaktimin e kësaj prokure të posaçme me përmbajtjen e mëposhtme:

"Unë i nënshkruari **Miodrag JANKOVIC**, jam aktualisht administrator dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë tregtare "**ALBAMETAL**" **SHA**, me seli në adresën: DURRES Lagjja Nr.4, rruga Skenderbej, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë, me Nr. NIPT-i L43402201R ,sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Me anën e kësaj prokure, në cilësinë e administratorit/përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "**ALBAMETAL**" **SHA**, autorizoj dhe caktoj si përfaqësues të "**ALBAMETAL**" **SHA** **Z. ANDI TOÇI**, shtetas shqiptar, i biri i Vasil-it, i datëlindjes 11.05.1995, lindur në Elbasan dhe banues në adresën: Lagja "Partizani" Rruga: "Janaq Kilica" pallati nr 11 ,Hyrja:A, Ap:4 Elbasan mbajtës i letërnjoftimit shqiptar Nr. 031180053 dhe Nr. Personal J50511078N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili të përfaqësojë shoqërinë tregtare "**ALBAMETAL**" **SHA**, pranë çdo banke në Republikën e Shqipërisë.

Përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë çdo lloj veprimi pranë bankave të ndryshme apo institucioneve financiare publike e private në Republikën e Shqipërisë, të mbrojë interesat e shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë pranë tyre, të derdhë apo të tërheqë vlera të ndryshme monetare në çfarëdo shume, të hapë llogari të ndryshme bankare duke nënshkruar kontratat përkatëse si dhe çdo veprim tjetër të mundshëm që ka të bëjë me bankat në Republikën e Shqipërisë. -----

Nëse është e nevojshme apo kur dhe ai vetë e sheh të nevojshme, përfaqësuesi ka të drejtë të delegejë një pjesë apo të gjitha tagrat e dhëna sipas kësaj prokure personave të tjerë. Për këtë qëllim ai ka të drejtë që nëpërmjet një autorizimi të shkruar ose të autorizojë me prokure të posaçme në emër të shoqërisë persona të tjerë për kryerjen e veprimeve specifike. -----

Miodrag Jankovic
Durrës - Albania

ALMA ÇAUSHI
NIPT: L43402201R

Kjo prokurë lëshohet pa afat dhe është e vlefshme deri në shfuqizimin e saj nga ana ime apo kur vetë përfaqësuesi heq dorë prej saj.

Të gjitha prokurat e mëparëshme të lëshuara nga "ALBAMETAL" SHA para datës së nënshkrimit të kësaj prokure, mbi caktimin si përfaqësues të kësaj shoqërie z. Andi TOÇI, shfuqizohen dhe vetëm kjo prokurë është në fuqi për z. Andi TOÇI.

Unë, Noteri, pasi e redaktova prokurën ne 8 (tete) kopje dhe ka një kohëzgjatje deri ne realizimin e qëllimit për te cilën është lëshuar kjo prokure, ia lexova me zë të lartë të përfaqësuarit i cili e dëgjoi, e miratoi dhe në prezencën time e nënshkroi pa vërejtje. Unë, duke e gjetur të rregullt dhe në përputhje me ligjin, e legalizoj duke e nënshkruar edhe vetë dhe e vulos.

I PËRFAQËSUARI
z. Miodrag JANKOVIC
Administrator i Shoqërisë
"ALBAMETAL" SHA

Miodrag Jankovic
Sha
Durrës - Albania



NOTERI
EVIS J.KOBURJA

Evís J. Koburja



Përkthyes: Alma Caushi

